



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparografi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparografi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparografi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro IT Solutions" Sh.P.K. të datës 28.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona , Bregu i Dielli, Ulpiana, Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro IT Solutions" Sh.P.K. të datës 28.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona , Bregu i Dielli, Ulpiana, Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Pro IT Solutions" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi i paisjeve tjera për sigurinë në komunikacion-Zona 1 Qendra- Tophane , Dodona , Bregu i Dielli, Ulpiana, Dardania , Lakërishta dhe Zona 2 Kodra e Trimave" me nr. të prokurimit 616-25-6001-5-1-1.

Faqe 1 nga 3

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

### Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

*“Duke iu referuar përbajtjes së Dosjes së Tenderit për aktivitetin në fjalë, ku është kerkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë përvojën e tyre përmes kontratave të ngashme me një vlerë minimale prej 500,000.00 Euro në tre vitet e fundit, ne vlerësojmë se është e nevojshme që kriteri i përcaktuar të saktësohet në mënyrë që të përfshijë edhe kontratat që përfshijnë punë ndërtimore të lidhura ngushtë me kontratën në fjalë. Kerkime qe në këtë kontekst si “punë të ngashme” të konsiderohen edhe ato kontrata që përfshijnë punë ndërtimore, si p.sh.: • ndërtimin e rrugëve, • punët infrastrukturore dhe përgatitore që shërbejnë për vendosjen e elementeve të sinjalizimit rrugor, • si dhe çdo aktivitet ndërtimor teknik që lidhet funksionalisht me objektin e kontratës. Arsyjeja e kësaj kërkesë bazohet në faktin se punët ndërtimore që lidhen me sinjalizimin dhe rrjetet infrastrukturore janë të një natyre të ngashme teknike dhe kërkijnë kompetenca të njëjtë profesionale, duke qenë pjesë e zbatimit të sukseshëm të projekteve me karakter të ngashiëm. Një vendim i tillë do të kontribuonte në një proces vlerësimi më të drejtë dhe transparent, duke u siguruar që operatorët ekonomikë me përvojë të vërtetuar në punë të ngashme të kenë mundësi të garojnë në mënyrë të barabartë dhe efektive në këtë tende”.*

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kerkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kerkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përsqegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kerkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se Autoriteti Kontraktues përmes komisionit vlerësues e ka kompetencën e plotë ligjore për të vlerësuar se cilat kontrata janë të ngashme ose jo në përputhje me dispozitat përkatëse të UPP, RRPP dhe LPP por edhe me interpretimet e publikuara nga KRPP lidhur me çështjen në fjalë. Sidoqoftë, kërkesa e DT është formuluar në mënyrë të drejtë dhe të duhur prandaj nuk ka nevojë që të korrigohet.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërsi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënati më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi,

Prishtinë, 01.09.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.